



Buxhetimi dhe Monitorimi me Pjesëmarrje në Korçë dhe Pogradec

Qëllimi i projektit

Projekti synoi forcimin e pjesëmarrjes së komunitetit dhe shoqërisë civile në Qeverisje, nëpërmjet angazhimit të tyre në të gjitha fazat e ciklit të buxhetit që lidhet me: identifikimin e investimeve sipas nevojave lokale, vlerësimin e kapaciteteve për të mbështetur projektet, përgatitjen e propozimit të buxhetit në këshill, mbikëqyrjen e procesit të miratimit të buxhetit, monitorimin dhe vlerësimin e punimeve publike dhe vazhdimësinë e procesit.

Fazat e zhvillimit të projektit

1. Mobilizimi i faktorëve dhe aktorëve të projektit: Ngritja e grupeve të punës në të dy qytetet me përfaqësues nga shoqëria civile, anetare të këshillit bashkiak dhe përfaqësues nga administratat e bashkive.

-U realizuan një sërë aktivitetesh për për ngritjen e kapaciteteve të aktorëve kryesorë të procesit në fushën e buxhetit dhe informimit qytetar;

- U përgatitën materialet sensibilizuese për komunitetin.

2. Organizimi i Cikleve të takimeve me komunitetet e Bashkive Korçë dhe Pogradec. Në këtë kuadër janë zhvilluar:

• Takime me Pushtetin Vendor për grumbullimin e të dhënave rreth buxhetit të kaluar dhe parashikimeve 2010;

• Përgatitja e prezantimeve në publik: mbi rezultatet që priten nga projekti i KE dhe mbi realizimin e investimeve 2008-2009 dhe projektet në vazhdim për vitin 2010;

• Ndarja e bashkive në zona për takimet me komunitetin, Korça në 6 zona, Pogradeci në 3;

• Dy raunde me takime të hapura me komunitetin e secilës zonë për përcaktimin e nevojave të tyre;

• Lista e prioriteteve të nevojave dhe sugjerimeve të çdo pjesëmarrësi në takim moren pjesë 245 qytetarë në takim, 20% femra, 120 propozime gjithsej (Korça). Në Pogradec moren pjesë 162 qytetarë në takim, 31% femra, u propozuan 43 investime dhe 48 përmirësimet shërbimesh.

• përzgjedhja e përfaqësuesve qytetarë, pjesë në Komisionin e Buxhetimit me Pjesëmarrje.

3. Ngritja dhe funksionimi i Komisionit të Buxhetimit me Pjesëmarrje, me antarë të

zgjedhur nga komuniteti dhe stafi i bashkisë në departamenti i financës, buxhetit dhe shërbimeve publike;

• Prioritizimi i nevojave të identifikuar si prioritare nga komunitetet gjatë takimeve të hapura, mbështetur në burimet e financimit sipas kriterëve të propozuar nga Grupi i punës.

• Studim i fizibilitetit të prioriteteve të propozuara dhe finalizimi i kësaj liste matrice.

• Dërgimi i kësaj Matrice në Grupet e Punës për diskutim me komisionin ekonomik të këshillit të Bashkisë, respektivisht.



4. Aprovimi i Buxhetit të vitit 2010 nga Këshilli Bashkiak. Ky komponent u shoqërua me aktivitete lobimi, sqarimi e ndërgjegjësimi, si takime, biseda e tryeza të rrumbullakëta.

• Grupi i Punës hartoi draftin e parë të buxhetit të bashkive, i cili u shqyrtua edhe njëherë nga

Komisioni Qytetar i Buxhetimit me Pjesëmarrje dhe përfaqësues të komunitetit

• U verifikuan në terren projektet prioritare

Korçë: Nga 18 priëritete të përzgjedhura nga komisioni qytetar, këshilli i Bashkisë do të

mbështesë 8 prej tyre. Pra, rreth 60% e fondit të investimeve do të mbështesë prioritetet qytetare.

Pogradec: Nga propozimet për investime nga qytetarët, buxheti do të mbështesë 6 ose 38 % të tyre. Iniciative e re nga procesi i buxhetimit me pjesëmarrje "Jepi zgjidhje" në Korçë: Nisma i përgjigjet kërkesave të qytetarëve në fushën e shërbimeve publike (nga takimet e BP ato zunë 56% të kërkesave. Pra, nisma synon rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve të mirëmbajtjes dhe zgjidhje të shpejtë të ankesave.

- Të gjitha shqetësimet e ngritura nga qytetarët

depozitohen pranë rajoneve administrative

- Verifikohen dhe fotografohen në terren problemet e ngritura

- U jepet zgjidhje brenda një jave nga strukturat e Bashkisë dhe fotografohet e raportohet ndryshimi

5. Ngrihen grupet monitoruese për dy investime prioritare që do të mbështeten me buxhetin 2010

-Trainohen grupet për këtë proces dhe ndahen detyrat në funksion të instrumenteve monitorues

- Përgatiten raportet për Bashkinë dhe grupet qytetare

6. Institucionalizohet procesi i BP (vazhdimësia e procesit)

FAKTET KRYESORE

PARTNERET:

✓ Komisioni Europian

KOHËZGJATIA:

2009 - 2011

PËRFITUESIT:

✓ Komuniteti Korçë dhe Pogradec

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtoresh Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë

Tel: +355 4 2256840

E-mail: uri@uri.org.al

Web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë në kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.